



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 qershor 2022
Nr. ref.:RK 2005/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI142/21

Parashtrues

Muharrem Aliu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
AC-I-19-0167 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
të 29 prillit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Muharrem Aliu, nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [AC-I-19-0167] të 29 prillit 2021, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së) në lidhje me Aktgjykimin [C-IV-14-3233] të 19 shtatorit 2019 të DHPGJS-së.
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së e ka pranuar më 6 maj 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 2 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë shkresë për plotësim të kërkesës.
9. Më 8 shtator 2021, Gjykata (i) njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës; dhe (ii) i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS-së.
10. Më 31 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që kërkesa të shqyrtohet në një seancë të ardhshme me plotësime shtesë.
11. Më 11 maj 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

12. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në Ndërmarrjen Shoqërore “Feronikeli” (në tekstin e mëtejme: NSH “Feronikeli”), në pozitën e arkëtarit, deri më 29 prill 1992 kur me Vendimin [nr.736] i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë pranë NSH “Feronikeli” për anulimin e Vendimit të lartpërmendur të 29 prillit 1992, për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Përmes Vendimit [nr.1541] të 31 korrikut 1992, NSH “Feronikeli” ankesën e parashtruesit të kërkesës u refuzua.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar kthim në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet që burojnë nga marrëdhënia e punës.
15. Më 7 prill 1998, Gjykata Komunale në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [P.1.nr.4741/92] e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke detyruar NSH “Feronikeli” që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në marrëdhënie të punës, në vendin e punës në të cilin kishte qenë, me të gjitha të drejtat e punës, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në ekzekutimin e vendimit të lartpërmendur.
16. Nga shkresat e lëndës të cilat parashtruesi i kërkesës i kishte dorëzuar në Gjykatë, nuk mund të konstatohet se parashtruesi i kërkesës në ndonjë fazë të mëvonshme të këtë paraqitur kërkesë në NSH “Feronikeli” për zbatimin e vendimit gjyqësor apo që ka iniciuar ndonjë procedurë përmbartimore me qëllim të zbatimit të vendimit gjyqësor për kthimin e tij në vendim e punës, apo realizimin e të drejtave që burojnë nga Aktgjykimi [P.1.nr.4741/92] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 7 prillit 1998.
17. Sipas parashtruesit të kërkesës, si rezultat i rrethanave në atë kohë, parashtruesi i kërkesës nuk kishte pasur mundësi që të realizojë zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
18. Më 20 prill 2006, NSH “Feronikeli” u privatizua ndërkaq me 4 korrik 2006, iu nënshtrua procesit të likuidimit. Si rrjedhojë, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM), në ueb-faqen e saj dhe në gazetën “Koha Ditore”, publikoi njoftimin lidhur me mundësinë e aplikimit të kreditorëve të NSH “Feronikeli”, për të dorëzuar kërkesat për likuidim më së largu deri më 26 shtator 2006.
19. Më 3 gusht 2007, parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar kërkesën e tij në Agjencinë Kosovare për Privatizim (në tekstin e mëtejme: AKP) për kompensimin e pagave të papaguara në vlerë prej 59.200.00 euro, me kamatë ligjore, gjatë periudhës së largimit të kundërligjshëm nga puna.

20. Më 3 tetor 2013, Autoritetit për Likuidim i AKP-së, i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës një shkresë, në bazë të së cilës i kishte dhënë mundësinë parashtruesit të kërkesës që të sqaronte arsyet e tij lidhur me parashtrimin e kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara pranë AKP-së, jashtë afatit të përcaktuar kohor.
21. Nga shkresat e rastit rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk është përgjigjur në shkresën e lartpërmendur të Autoritetit për Likuidim të AKP-së.
22. Më 7 prill 2014, Autoriteti për Likuidim pranë AKP-së, pasi që i kishte dhënë mundësinë parashtruesit të kërkesës që të jepte arsyet për kërkesën e parashtruar pas afatit, përmes Vendimit me numër protokolli [2903], e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, si të pasafatshme.
23. Më 28 prill 2014, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi ankesë kundër Vendimit të lartcekur të 7 prillit 2014, në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, duke kërkuar, ndër tjerash, ndryshimin e Vendimit dhe njohjen e të drejtës në pagat e papaguara si rezultat i largimit të kundërligjshëm nga puna. Për më tepër, në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës kishte kundërshtuar konstatimin e Autoritetit për Likuidim të AKP-së, lidhur me pranimin e kërkesës për informata shtesë më 3 tetor 2013.
24. Më 7 dhjetor 2016, AKP kishte parashtruar përgjigje në ankesë duke i kërkuar DHPGJS-së refuzimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës, si të papranueshme si dhe vërtetimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Sipas AKP-së, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën për kompensim të pagave të papaguara më 3 gusht 2007, jashtë afatit të përcaktuar dhe pa specifikuar periudhën e pretenduar. Si rrjedhojë, Autoriteti i Likuidimit përmes letrës së 3 tetorit 2013, dërguar në adresën e specifikuar nga parashtruesi i kërkesës, si dhe pranuar nga vet ai personalisht, i kishte kërkuar parashtruesit të kërkesës që në afat prej 15 ditësh të arsyetonte dorëzimin me vonesë të kërkesës, të specifikonte periudhën e pretenduar si dhe të ofronte dëshmi të tjera relevante, mirëpo që parashtruesi i kërkesës kishte dështuar që të njëjtat t'ia ofrojë Autoritetit të Likuidimit.
25. Më 27 janar 2017, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në DHPSGJ përgjigje në parashtrësën e AKP-së, duke theksuar se pranimi i letrës së 3 tetorit 2013 ishte bërë në NSH "Feronikeli" dhe jo nga parashtruesi i kërkesës si dhe nënshkrimi i marrësit në fletkthesë nuk ishte i tij.
26. Më 19 shtator 2019, Kolegji i Specializuar i DHPGJS, përmes Aktgjykimit [C-IV-14-3233], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin e Autoritetit të Likuidimit të 4 prillit 2014, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në arsyetimin e Aktgjykimit të DHPGJS-së theksohet se parashtruesi i kërkesës, kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së, e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i përcaktuar në njoftimin e AKM-së si dhe nuk kishte sjellë dëshmi që do të kishin justifikuar vonesën në parashtrimin e kërkesës.

27. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të DHPGJS-së, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës theksoi se vlerësimi i DHPGJS-së në raport me konstatimin e AKP-së për pranimin nga parashtruesi i kërkesës të shkresës së 7 tetorit 2013, ishte i pasaktë. Sipas parashtruesit të kërkesës, edhe pse fletkthesa përmbante adresën e tij, nga posta shihej qartë që AKP kishte dërguar letrën në NSH "Feronikeli". Gjithashtu, në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës, pretendoi zbatim të gabuar të ligjit si rezultat i referimit të DHPGJS-së në dispozita ligjore të aprovuara pas parashtrimin të kërkesës së tij në AKP. Në ankesën e parashtruar tek Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me pretendimin se DHPGJS edhe në vendime të tjera të mëhershme kishte vendosur në favor të palëve që kishin kërkuar pagesë në bazë të aktgjyimeve të formës së prerë, parashtruesi i kërkesës iu referua Aktgjykimit të DHPGJS-së [SCC-11-0039] të 4 korrikut 2012.
28. Më 1 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi parashtrësë-urgjencë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së duke bashkëngjitur Letër-konfirmimin e AKP-së mbi përvojën e punës, nxjerrë me 27 janar 2021.
29. Më 29 prill 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [AC-I-19-0167], ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar, duke vërtetuar Aktgjykimin të 19 shtatorit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së. Përmes këtij Aktgjykimi, Kolegji i Apelit, duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 [Procedurat e ankesës me gojë] të Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, kishte specifikuar se: "*Kolegji i Apelit vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurës*", ndërsa, në pjesën përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës, kishte arsyetuar se: (i) parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar kërkesën e tij për kompensim tek Autoriteti i Likuidimit; (ii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës se nuk ishte njoftuar personalisht me kërkesën e AKP-së për arsyetim të vonës në parashtrim të kërkesës, është i pabazuar sepse nga fletkthesa dëshmohej se 7 tetori 2013 ishte datë e pranimit si dhe nënshkrimi i marrësit mbante inicialet e tij; (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë i kujdesshëm që të përcjellë afatet e paraqitjes së kërkesës; dhe (iv) se parashtruesi i kërkesës, edhe pse i është referuar Aktgjykimit të 7 prillit 1998, ai nuk kishte sjellë kopje të këtij vendimi ku theksohej se i është pranuar kompensimi i të ardhurave personale për periudhën e ndërprerjes së kundërligjshme të marrëdhënies së punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
31. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është nxjerrë në kundërshtim me garancitë

procedurale për mos-zbatim të aktgjykimit të formës së prerë, duke theksuar se *“Aktgjykimet e gjykatave duhet edhe të përmbahen, çka nuk është vepruar kështu në rastin e ankuesit sepse nuk i është njoftë kompensimi i të ardhurave në procedurë të likuidimit për kohën e largimit të kundërligjshëm edhe pse me aktgjykim të formës së prerë kjo e drejtë i është gjykuar-njoftë ankuesit”*.

32. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 3 dhe nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me palët e tjera nga organet vendimmarrëse të AKP-së. Sipas parashtruesit të kërkesës, DHPGJS nuk ka marrë parasysh pretendimin e tij për largim të kundërligjshëm nga puna si dhe provat e ofruara nga ai, siç është shkresa e AKP-së për njohje të përvojës së punës si dhe vendimi i DHPGJS-së në një rast tjetër të ngjashëm.
33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu përmes plotësimit të kërkesës së tij fillestare, dorëzuar në Gjykatës më 2 shtator 2021, kishte ngritur pretendime që ndërlidhen me (i) mos-mbajtje të seancës dëgjimore lidhur me rastin e tij. Në ndërlidhje me këtë Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, përmes shkresës për plotësim të kërkesës të 2 shtatorit 2021, i është referuar praktikës së Gjykatës, konkretisht Aktgjykimit në rastin KIO1/20 të 13 gushtit 2021, në kontekst të së drejtës për caktim të seancës dëgjimore. Në këtë shkresë shtohet se: *“Parashtruesi i kërkesës dëshiron që kjo parashtrësë ti bashkëngjitet kërkesës bazë të dorëzuar në Gjykatë ngase në rastin e parashtruesit me vendimet e goditura në kërkesë, është vepruar në mënyrë të njëjtë si në rastin e sipërcituar ku të dy instancat gjyqësore nuk kanë caktuar fare seanca dëgjimore lidhur me ankesën-padinë e ankuesit edhe përkundër faktit se me vendim përfundimtar gjyqësor ankuesit, organet e atëhershme gjyqësore i kanë njoftë të drejtat nga marrëdhënia e punës për kohën e largimit të kundërligjshëm, këtë të drejtë nuk ja kanë bërë instancat gjyqësore të shkallës së parë dhe të dytë të Dhomës së Posaçme si gjykatë e veçantë, në Kosovë, edhe pse ankuesi është thirrë në diskriminim dhe ka ofruar prova për këtë”*.
34. Gjithashtu, në mbështetje të pretendimit të tij për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës së GJEDNJ-së, në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (App.Nr.13071/87) (Aktgjykim i 10 korrikut 1991) si dhe praktikës së Gjykatës në rastin KI49/11, me parashtrues *Ibrahim Sokoli*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2009, të 4 shkurtit 2011.
35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë se ka shkelje të Kushtetutës dhe që të shfuqizojë vendimet e kontestuara, duke e kthyer rastin në rigjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3 **[Barazia para Ligjit]**

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31 **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 **E drejta për një proces të rregullt**

1. E drejta për një proces të rregullt 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës

civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Ligji Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 76

Konfliktet dhe interpretimi

[...]

3. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Ligji Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 7

7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

7.2 Gjykata është e autorizuar ti vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

7.3 Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.

Neni 399

399.1 Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.

399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 23

Obligimet e palëve në procedurë

1. *Palët, në parashitresat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës. Dhoma e Posaçme sipas detyrës zyrtare bën hetimin e fakteve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.*
2. *Dhoma e Posaçme duhet t'i inkurajojë palët që të arrijnë zgjidhje me negociata para dhe gjatë cilësdo procedurë.*
3. *Në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore, palët veprojnë në mënyrë të singertë.*
4. *Secila palë, në parashitresat e saj me shkrim, duhet të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj.*
5. *Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.*

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 23

Dëshmitë e kërkesës apo interesit

- [...]
1. *Formulari i Dëshmisë së interesit duhet t'i përfshijë informatat në vijim:*
[...]
2.4.kopje të kontratave me shkrim dhe dokumenteve të tjera që kanë për qëllim vërtetimin e interesit të pretenduar;
 2. *Autoriteti i Likuidimit ka të drejtë të kërkojë nga personi që ka parashtruar Dëshmi të Kërkesës apo Dëshmi të Interesit të ofrojë informata apo dokumente shtesë të cilat Autoriteti i Likuidimit konsideron se janë të domosdoshme apo të përshtatshme për përcaktimin e vlefshmërisë së Kërkesës apo Interesit në fjalë.*
- [...]

Neni 35

Njoftimi për kreditorin dhe Afati për parashtrimin e kërkesave

- [...]
3. *Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion*

vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo 43 Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave.

Neni 36

Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta

[...]

2. Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:

2.2.dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese; apo

[...]

Vlerësimi i kërkesës për plotësimin e kërkesës si dhe vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

(i) Vlerësimi i kërkesës për plotësimin e kërkesës

36. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për plotësimin e kërkesës së tij, të parashtruar më 2 shtator 2021, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për plotësimin e kërkesës, së parashtruar më 10 gusht 2021. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se kjo parashtruesë nuk përmbante kërkesë për përmirësim të gabimeve teknike ose numerike, por përmbante plotësimin e pretendimit të tij në lidhje mos mbajtje të seancës dëgjimore në asnjë instancë, lidhur me rastin e tij.
37. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës, i cili përcakton që *“Në qfarëdo kohe, para se gjyqtari raportues të ketë paraqitur raportin e tij, pala, e cila e ka parashtruar kërkesën, ose Gjykata ex officio, mund të dorëzojë në Sekretariat përmirësimin e gabimeve teknike ose numerike në materialin e parashtruar”*.
38. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 33 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit) të Rregullores së punës që përcaktojnë:

Neni 22

[Procedimi i kërkesës]

“4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.”

Rregulli 33
(Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit)

[...]

(2) Nëse një kërkesë nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme, Gjyqtari raportues nëpërmjet Sekretariatit e njofton parashtruesin e kërkesës, kontaktet e të cilit janë të njohura, se kërkesa duhet të plotësohet me dokumentet e specifikuar në kërkesë dhe përcakton saktë se këto dokumente duhet të dorëzohen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(3) Përveç nëse kërkohet nga Gjykata ose, nëse merret leje me shkrim nga Gjykata, pala nuk mund të dorëzojë asnjë dokument pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë një afat më të shkurtër, kur një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar.”
[...]

39. Gjykata, duke u bazuar në paragrafin (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës, përsërit se parashtruesi e parashtruesit të kërkesës e dorëzuar më 2 shtator 2021 përmban plotësimin e pretendimit për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] duke pretenduar si në vijim “*Parashtruesi i kërkesës dëshiron që kjo parashtruesë të bashkëngjitet kërkesës bazë të dorëzuar në Gjykatë ngase në rastin e parashtruesit me vendimet e goditura në kërkesë, është vepruar në mënyrë të njëjtë si në rastin e sipërcituar ku të dy instancat gjyqësore nuk kanë caktuar fare seanca dëgjimore lidhur me ankesën-padinë e ankuesit edhe përkundër faktit se me vendim përfundimtar gjyqësor ankuesit, organet e atëhershme gjyqësore i kanë njoftë të drejtat nga marrëdhënia e punës për kohën e largimit të kundërligjshëm, këtë të drejtë nuk ja kanë bërë instancat gjyqësore të shkallës së parë dhe të dytë të Dhomës së Posaçme si gjykatë e veçantë, në Kosovë, edhe pse ankuesi është thirrë në diskriminim dhe ka ofruar prova për këtë”.*
40. Në dritën e elaborimit si më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës për plotësimin e kërkesës është dorëzuar jashtë afateve procedurale dhe bie jashtë fushëveprimit të rregullave të sipërcekura, dhe kjo për arsye se kërkesa fillestare është dorëzuar më 10 gusht 2021, ndërsa dokumentet shtesë për plotësimin e pretendimit të saj janë dorëzuar më 2 shtator 2021. Për me tepër, parashtruesi e dorëzuar më 2 shtator 2021 nuk ka të bëjë me përmirësimin e gabimeve teknike apo numerike të kërkesës fillestare, por ndërlidhet me plotësimin e pretendimit dhe dorëzimin e informatës shtesë.
41. Në linjë me atë që u tha më lart, Gjykata i referohet edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), ku kjo e fundit në raste të ngjashme kishte konstatuar se pretendimet e parashtruesve të parashtruar pas kërkesës fillestare dhe që rezultojnë se janë parashtruar pas kalimit të afatit 4 mujor refuzohen të papranueshme si të pasafatshme (shih rastin e GJEDNJ-së, *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë, Aktgjykim i 20 marsit 2018, paragrafi 137 dhe 138*).

42. Rrjedhimisht, Gjykata si rezultat i këtij konstatimi do të vazhdojë më shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur në kërkesën e dorëzuar më 10 gusht 2021.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata së pari, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

45. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”

46. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-19-0167] të 29 prillit 2021 të Kolegjit të Apelit në

lidhje me Aktgjykimin [C-IV-14-3233] të 19 shtatorit 2019 të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka specifikuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

47. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

48. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
49. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*".
50. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
51. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e Ndërmarrjes Shoqërore NSH "Feronikeli" dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për parashtrimin e kërkesave kreditore. Parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në NSH "Feronikeli", deri më 29 prill 1992 kur i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Pas inicimit të procedurës gjyqësore, më 7 prill 1998, Gjykata Komunale në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [P.1.nr.4741/92] e aprovoi

kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke detyruar NSH “Feronikeli” që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në marrëdhënie të punës, në vendin e punës në të cilin kishte qenë, me të gjitha të drejtat e punës, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në kthimin në punë. Si rezultat i rrethanave në atë kohë, parashtruesi i kërkesës nuk kishte pasur mundësi që të realizojë zbatimin e Aktgjykimit të lartcekur. Pas privatizimit të NSH “Feronikeli” në prill të vitit 2006, kjo e fundit, në korrik të po të njëjtit vit, iu nënshtrua procesit të likuidimit. Në këtë aspekt, më 26 korrik 2006, AKM kishte publikuar në ueb-faqe si dhe në gazetën “Koha Ditore”, njoftim lidhur me mundësinë e aplikimit të kreditorëve të NSH “Feronikeli” deri më 26 shtator 2006. Më 3 gusht 2007, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij në AKP për kompensimin e pagave të papaguara. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës u refuzua nga Autoriteti për Likuidim i AKP-së përmes vendimit të 7 prillit 2014.

52. Kundër Vendimit [2903] të 7 prillit 2014, të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në DHPGJS, duke kërkuar ndryshimin e Vendimit dhe njohjen e të drejtës në pagat e papaguara si rezultat i largimit të kundërligjshëm nga puna si dhe duke kundërshtuar konstatimin e Komisionit për Likuidim të AKP-së, lidhur me pranimin e kërkesës për informata shitesë më 3 tetor 2013. Kundër ankesës së parashtruesit të kërkesës, AKP kishte parashtruar mbrojtje në ankesë duke i kërkuar DHPGJS-së refuzimin e ankesës si të papranueshme dhe/ose të pabazuar si dhe vërtetimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Sipas AKP-së, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën për kompensim të pagave të papaguara jashtë afatit të përcaktuar dhe pa e specifikuar periudhën e pretenduar si dhe kishte dështuar që të ofrojë justifikim të vonësës, edhe pas letrës së 3 tetorit 2013, dërguar tek ai nga AKP-ja. DHPGJS, në shkallë të parë, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin e Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kundër këtij të fundit, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, me pretendimin për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
53. Të gjitha këto konstatime parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës, duke pretenduar në thelb se janë shkelur dy komponentë të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe që kanë të bëjnë me: (i) moszbatim të vendimit të formës së prerë, në mënyrë specifike të Aktgjykimit [P.1.nr.4741/92] të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 7 prillit 1998; dhe (ii) pretendimit për shkeljen e nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës. Gjykata në vijim këto dy pretendime do t'i trajtoj ndaras.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për moszbatim të vendimit të formës së prerë

54. Së pari, Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës në këtë drejtim i cili thekson se: “Aktgjykimet e gjykatave duhet edhe të përmbahen, çka nuk është vepruar kështu në rastin e ankuesit sepse nuk i është njoftë kompensimi i të ardhurave në procedurë të likuidimit për kohën e largimit të kundërligjshëm edhe pse me aktgjykim të formës së prerë kjo e drejtë i është gjykuar-njoftë ankuesit”.

55. Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës këtë pretendim e ka ngritur edhe në gjykatat e rregullta.
56. Gjykata së pari rikujton se Autoriteti për Likuidim pranë AKP-së, pas mundësisë që i kishte dhënë parashtruesit të kërkesës që të jepte arsyet për kërkesën për kompensim të parashtruar pas afatit, dhe një gjë të tillë bazuar në shkresat e lëndës parashtruesi i kërkesës nuk e kishte bërë, më pas kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pasaftatshme.
57. Më tutje, ky qëndrim ishte mbështetur edhe nga instancat gjyqësore. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [AC-I-19-0167] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 20 prillit 2021, i cili gjatë adresimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës pasi që kishte konstatuar se vendimi i shkallës së parë ishte i saktë, ndër të tjera kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës: *“pas afatit të përcaktuar me njoftimin për paraqitjen e kërkesave, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit kërkesën e tij për kompensim. Paditësi vazhdimisht ka pretenduar në këtë procedurë se ai nuk ishte njoftuar personalisht, për kërkesën e AKP-së për justifikim të vlefshëm për vonesën e kërkesës si dhe për ofrim të dokumenteve shtesë, pasi që ai pretendon se nuk ka pranuar kurrfarë kërkesë nga AKP-ja. Kolegji i Apelit e ka pasur këtë pretendim, por vlerëson se ai pretendim nuk është i bazuar. Është e qartë se AKP-ja e ka dorëzuar tek paditësi këtë kërkesë pasi që shihet qartë kopja e fletkthesës e cila ekziston në dosje e cila mbanë të dhënat.[...] Gjithashtu mbanë datën 07.10.2013 si datë e pranimit si dhe nënshkrimi i marrësit mbanë inicialet e paditësit.”*. Kolegji i AKP-së tutje e refuzoi këtë pretendim si të pabazuar sepse nga gjendja faktike e konstatuar rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë i njoftuar me kërkesën e AKP-së. Më tutje, në aktgjykimin e lartpërmendur shtohet se: *“Paditësi në këtë rast është e qartë se nuk ka qenë i kujdesshëm ti përcjellë afatet e paraqitjes së kësaj kërkesë, andaj ai duhet të përballet me pasojat e dështimit të tij”*.
58. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se në rastin e tij kishte një vendim të formës së prerë i cili duhet zbatuar, Kolegji i Apeli i DHPGJ-së thekson: *“Paditësi në procedurë çdo herë ka përmendur Aktgjykimin e plotfuqishëm C.nr. 4741/92 të datës 07.04.1998 mirëpo ai asnjëherë nuk ka sjellur si dëshmi një kopje të këtij vendimi ku thotë se i janë pranuar kompensimi i të ardhurave personale për kohën e kundërligjshme të marrëdhënies së punës”*.
59. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata vëren se Vendimi i Autoritetit të Likuidimit u mbështet edhe nga Kolegji i Specializuar dhe nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, e duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte sjellë dëshmi që do të kishin justifikuar vonesën në parashtrimin e kërkesës për kompensim si dhe duke theksuar faktin se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk ka sjellur si dëshmi një kopje të këtij vendimi ku thotë se i është pranuar kompensimi i të ardhurave personale për kohën e kundërligjshme të largimit të tij nga marrëdhënia e punës.
60. Nga si më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Aktgjykimi [AC-I-19-0167] i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i 20 prillit 2021, si dhe vendimi i Kolegjit të Specializuar janë të qartë në kuptim të adresimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, lidhur me moszbatimin e vendimit të formës së prerë.

61. Gjykata vëren se çështja e vendimit të formës së prerë, respektivisht e Aktgjykimit [P.1.nr.4741/92] të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 7 prillit 1998, nuk është kontestuar nga gjykatat e rregullta dhe për më tepër kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensim të pagave është refuzuar si e pasafatshme, bazuar në faktin se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk ka sjellur si dëshmi një kopje të vendimit të lartpërmendur ku thotë se i janë pranuar kompensimi i të ardhurave personale për kohën e kundërligjshme të marrëdhënies së punës.
62. Nga faktet e rastit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkesën e tij për kompensim të pagave, nuk ka mundur ta realizojë për shkak të lëshimeve të afateve ligjore pranë organeve kompetente si dhe për shkak të mos ofrimit të dëshmive përkatëse.
63. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar nuk karakterizohet me arbitraritet në vendosje.
64. Gjykata vëren se këtë pretendim parashtruesi i kërkesës përveç që e ka përmendur si fakt, nuk e ka elaboruar më tutje se si Kolegji i Apelit gjatë vendosjes së rastit kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të mbrojtura me Kushtetutë. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me asnjë argument këtë pretendim të tij.
65. Prandaj, Gjykata vlerëson se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës refuzohet si i pambështetur dhe rrjedhimisht i pabazuar ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës

66. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës, pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me palët e tjera nga organet vendimmarrëse të AKP-së. Sipas parashtruesit të kërkesës, DHPGJS nuk ka marrë parasysh pretendimin e tij për largim të kundërligjshëm nga puna si dhe provat e ofruara nga ai, siç është shkresa e AKP-së për njohje të përvojës së punës si dhe vendimi i DHPGJS-së në një rast tjetër të ngjashëm.
67. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, ose status, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e*

Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33; shih, po ashtu, rastet e GJEDNJ-së *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 7 dhjetor 1976, paragrafi 56; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 mars 2010, paragrafi 61). Sipas këtyre praktikave gjyqësore, jo çdo dallim në trajtim do të jetë diskriminues, por vetëm nëse i mungon justifikimi objektiv dhe i arsyeshëm, gjegjësisht nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse i mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit dhe referencat e tjera të përmendura aty).

68. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij se si është diskriminuar dhe, rrjedhimisht, nuk ka mbështetur pretendimin e tij për diskriminim në procedurë para gjykatave të rregullta.
69. Rrjedhimisht, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

Përfundim

70. Bazuar në gjithë atë që është thënë më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe faktet e paraqitura prej tij, Gjykata, bazuar në standardet e përcaktuara në praktiken e saj gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se: (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës “*për moszbatim të vendimit të formës së prerë*”, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është e përcaktuar me nenin 39 (2) të Rregullores së punë si “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; (ii) pretendimet lidhur me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës, përbëjnë gjithashtu pretendime qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) (2) të Rregullores së punës, më 11 maj 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani